URDHËR
Nr. 483, datë 19.9.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20 dhe shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial", i ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

A. Pika 4, e kreut II, ndryshon si më poshtë:

"*4. Numri i psikologëve/punonjësve socialë, në njësinë e shërbimit psikosocial, përcaktohet si vijon:*

a) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka 251–450 nxënës;

b) dy psikologë/punonjës socialë për çdo shkollë me 451 ose më shumë nxënës;

c) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka të paktën 8 nxënës me aftësi të kufizuara të përcaktuar me raport të Komisionit Mjekoligjor;

ç) një psikolog për çdo shkollë të arsimit special;

d) në rastet kur shkollat kanë numër më të vogël nxënësish, një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla dhe numri total i nxënësve do të jetë nga 80–250".

B. Pika 3, e kreut IV, ndryshon si më poshtë:

"3. DRAP-i, bazuar në kërkesën e ZVAP-së, shpall vendin e lirë të punës për psikologë/punonjës socialë, menjëherë sapo vendi i punës del i lirë".

C. Pika 7, e kreut IV, ndryshon si më poshtë:

"7. Për realizimin e procedurave të konkurimit dhe shpalljes së listës së kandidatëve fitues, DRAP-i përkatës krijon një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga 1 (një) përfaqësues nga AKAP-ja, 1 (një) përfaqësues nga DRAP dhe 1 (një) përfaqësues nga njëra prej ZVAP-ve".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani